



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në bazë të Nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L – 046 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe Nenit 5 të Rregullores nr.1327/18 të datës 10.10.2018 për Procedurat dhe kriteret në përzgjedhjen e përmbajtjeve audiovizual të producentëve të pavarur, si dhe Plotësim/Ndryshimin e Rregullores për Procedurat dhe kriteret në përzgjedhjen e përmbajtjeve audiovizuale të producentëve të pavarur me numër protokollit 0029/24 të datës 07.05.2024, Radiotelevizioni i Kosovës shpall:

Thirrje publike për producentë dhe produksione të pavarura

Me qëllim të pasurimit të skemës programore, RTK Radio kërkon realizimin e një Show emisioni humoristik për programin e natës.

- Të interesuarit preferohet të jenë profesionistë nga fusha e aktrimit dhe të paraqesin ide kreative origjinale.
- Të drejtë pjesëmarrje kanë edhe absolventët e degës së aktrimit ose të rinj të talentuar, entuziastë të kësaj fushe.
- Preferohet, por nuk është e domosdoshme që emisioni të drejtohet në çift.
- Kohëzgjatja e emisionit: 90 (nëntëdhjetë) minuta.
- Sasia: 17 episode premierë (një emision në javë).
- Kohëzgjatja e projektit: 4 (katër) muaj.
- Vlera monetare: 5,000 euro.
- Emisioni **do të xhirohet si video podcast nga RTK Radio** për publikim edhe në rrjetet sociale të RTK-së.

RTK Radio do të zotërojë të gjitha të drejtat e shfrytëzimit të secilit prej episodeve (emisioneve). Të drejtat do të jenë ekskluzive, të pakufizuara në kohë dhe pakufizim territorial.

Personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Një koncept të emisionit (skenar) dhe të jenë të gatshëm për ta elaboruar atë para komisionit profesional;
- Një pilot – projekt të emisionit;
- Një kopje të letërnjoftimit (ID) apo të pasaportës, të lëshuar nga Republika e Kosovës;
- CV e Producentit (autorit), ku të jetë e përfshirë “link” i veprave të mëparshme në vitet e fundit (nëse ka të tilla);
- Një Referencë;
- Të interesuarit që janë absolventë të degës së aktrimit, duhet të sjellin një Vërtetim nga Fakulteti i Arteve, Dega – Aktrim;
- Të mos jetë i dënuar për kryerjen e veprës penale (Vërtetim nga Gjykata), jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Të mos ketë proces gjyqësor me Radiotelevizionin e Kosovës;

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e aplikimit në postën elektronike: drejtoriradio@rtklive.com.

Aplikimet janë të hapura nga data 19.07.2024 deri me 02.08.2024 në ora 23:59)